



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



RREGULLA PËR KONSUMATORËT / PRODHUES (PROSUMATOR) ME BURIME TË RIPËRTËRITSHME TË ENERGJISË

DIHA - Diskutim Online mbi Prosumers Fotovoltaik ne Shqiperi dhe rajon

Janar 2024, Prishtinë/Virtual

RREGULLA PARAPRAKE 2017-2023



Ishte:

- Vetem konsumatorët e kështu në **nivelin e tensionit 0.4kV** kishin të drejtë të bëhen prosumatorë
- Fuqia maksimale e lejuar **100kW**
- Energjia e injektuar < Energjia e konsumuar
- Kompenzimi neto-matje (kWh-kWh)

RREGULA E RE

Baza Ligjore

Bazuar në autoritetin e dhënë të Zyrës së Rregullatorit për Energji, sipas dhe në pajtim me Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, Nenin 25, Neni 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084, Nenin 13 dhe 17 të Ligjit për Energjinë Nr. 05/L-081 dhe Vendimin nr. prot. 2365 të datës 13.07.2023 të nxjerr nga Ministria e Ekonomisë e Republikës së Kosovës për:

- Pelqimin e dhene per vazhdimin e procesit te SKE per vet-konsumatore;
- Zhvillimin e Skemes mbeshtese per vet-konsumatore;

Bordi i ZRRE ka mandat për shqyrtim dhe aprovim të Rregullës për: **RREGULLA PËR VET - KONSUMATORËT ME BURIME TË RIPËRTËRISHME**

QËLLIMI DHE FUSHËVEPRIMI I RREGULLËS

Kjo Rregull përcakton:

- Parimet e mbështetjes së Prosumatorëve dhe procedurën e aplikimit për t'u bërë Prosumator;
- Skemën Mbështetëse të Faturimit Neto 2023;
- Tarifën e Prosumatorëve (OS/OT) si një kontribut adekuat në uljen e ndikimit të tyre në koston e sistemit energjetik;
- Kërkesat minimale teknike për instalimet e teknologjisë; dhe
- Rregullon mekanizmin e prosumatorëve që veprojnë bashkërisht për banesat/ndërtesat kolektive.
- Pëcaktimin e kriterëve minimale teknike për kycje në rrjet

KRITERET E PRANUESHMËRISË



Behet:

- **Çdo** konsumator i energjisë elektrike, i lidhur në **rrjetin e shpërndarjes ose transmetimit**, ka të drejtë të bëhet Prosumator;
- Konsumatorët mund të marrin statusin e prosumatorit jashtë skemave mbështetëse - kufizimet ekzistuese në lidhje me kapacitetin e instaluar dhe nivelet e tensionit janë hequr;
- ZRRE pas kërkesës me shkrim të konsumatorit sipas Rregullës së Autorizimit, lëshon autorizim për ndërtim dhe përcakton Statusin e Prosumatorit pavarësisht nëse është nën apo mbi prag;

KRITERET E PERGJITHSHME TE PRANUESHMËRISË

Konsumatori i energjisë elektrike merr statusin e Prosumatorit nëse:

- Ka pëlqimin energjetik të KEDS ose KOSTT (operatorët e rrjetit)
- Sistemi i instaluar i prosumatorit duhet të jetë i ri dhe i kyçur me instalimin e brendshëm
- Kapaciteti total i instaluar duhet të jetë i barabartë ose më i vogël se kapaciteti i kontraktuar i kyçjes së konsumatorit
- Sasia vjetore e energjisë së tepërt të injektuar në rrjet duhet të jetë më e ulët se sasia e energjisë elektrike të tërhequr nga rrjeti gjatë të njëjtit vit.

PRAGJET PËR PËRFSHIRJE NË SKEMAT MBËSHTETËSE

Të gjithë Prosumatorët e autorizuar mund të aplikojnë për t'u përfshirë në Skemën Mbështetëse

Kapaciteti i instaluar i lejuar për pjesëmarrje në Skemën Mbështetëse:

- Për konsumatorët familjarë - bazuar në energjinë e konsumuar dhe Pëlqimin Energjetik (nuk duhet të kalojë 7 kW)
- Për konsumatorët jo-familjarë (në rrjetin e shpërndarjes së tensionit të ulët) - bazuar në energjinë e konsumuar dhe Pëlqimin e Energjetik (nuk duhet të kalojë 15 kW)
- Për konsumatorët jo-familjarë (në rrjetin e shpërndarjes së tensionit të ulët) - bazuar në energjinë e konsumuar dhe Pëlqimin Energjetik (nuk duhet të kalojë 100 kW)
- Për konsumatorët jo-familjarë të lidhur në **tensionin e mesëm** dhe rrjetin e transmetimit - bazuar në fuqinë mesatare të angazhuar gjatë një periudhe 12-mujore dhe bazuar në Pëlqimin Energjetik (nuk duhet të kalojë 200 kW)

METODOLOGJIA E LLOGARITJES SË KAPACITETIT TË LEJUAR PËR SKEMË MBËSHTETËSE

Për konsumatorët familjar dhe për konsumatorët jo-familjar të kyçur në nivelin 0.4kV të cilët nuk faturohen për fuqinë e angazhuar, kalkulimi i fuqisë së lejuar bëhet sipas formulës:

$$P_{mest} = \frac{\sum_{i=1}^{12} W_i}{n * C}$$

W_i energjia e konsumuar gjatë muajit - kWh

n – numri i oreve në një vit – 8760

C – koeficienti i prodhimit të PV – 0.156

i – numri rendor i muajit të vitit

Për konsumatorët familjar dhe jo-familjar të kyçur në 0.4kV, kurdo që

$$P_{mest} < P_{pelqim}$$

Autorizimi ipet për P_{mes} në të kundërtën ipet sipas Pëlqimit Energjetik

METODOLOGJIA E LLOGARITJES SË KAPACITETIT TË LEJUAR PËR SKEMË MBËSHTETËSE

Për konsumatorët jo-familjar në 0.4kV të cilët faturohen edhe për fuqinë aktive të angazhuar, për konsumatorët e kyçur në nivelin 10kV, 35kV, si dhe për konsumatorët e kyçur në nivel të transmetimit, kalkulimi i fuqisë së lejuar bëhet sipas formulës:

$$P_{mest} = \frac{\sum_{i=1}^{12} P_{max_i}}{n}$$

P_{mest} është fuqia mesatare vjetore e angazhuar - kW

P_{max_i} fuqia maksimale e rexhistruar në maksigraf gjatë muajit i- kW

n – numri i muajve në një vit – 12

i – numri rendor i muajit të vitit

METODA E KOMPENZIMIT/NË SKEMË MBËSHTETESE

- Furnizuesi Universal është i detyruar t'i ofrojë Prosumatorit një marrëveshje 12-vjeçare të blerjes së energjisë elektrike (MBE);
- Konsumatorët kompensohen për energjinë e tepërt të injektuar në rrjet (vlera monetare e kredituar në faturat e llogarisë së tyre të energjisë elektrike);

$$\zeta_{tepert}^{PT} = C \times \zeta_{furnizuar}^{PT}$$

ζ_{tepert}^{PT} – Çmimi për energjinë elektrike të tepërt gjatë periudhës tarifore PT dhe brenda periudhës së faturimit;

$\zeta_{furnizuar}^{PT}$ – Çmimi i furnizimit me energji elektrike i llogaritur nga ZRRE gjatë periudhës tarifore PT (vetëm komponenti energjetik i çmimit të furnizimit me energji elektrike, pa tarifë dhendonjë pagesë dhe taksë tjetër) brenda periudhës së

- $C = 0.85$ per prosumatoret ne skeme ne 0.4kV, ndersa 0.8 per TU dhe TL, dhe prosumatoret jashte skemes jo <0.7
- Rivendosja e kreditimit më 1 janar dhe 1 korrik të çdo viti;

PROSUMATORËT JASHTË SKEMËS MBËSHTETËSE

- Konsumatorët mund të jenë prosumatorë jashtë skemës mbështetëse të faturimit neto, nëse :
 - Kapaciteti total i instaluar i objektit vetë-gjenerues është mbi pragun
 - Kapaciteti total i instaluar i objektit vetë-gjenerues deri dhe i barabartë me pragun, por që nuk dëshirojnë të jenë nën skemën mbështetëse të faturimit neto
 - Ata kanë ushtruar tashmë të drejtën për skema të tjera mbështetëse
- Mund t'i shesin energjinë e tepërt Furnizuesit në bazë të një kontrate të përbashkët (çmimi i energjisë së tepërt përcaktohet nga tregu)
- Duhet të jenë të autorizuar (vlen të njëjtat kritere autorizimi)

PROSUMATORËT QË VEPROJNË BASHKËRISHT

- Çdo dy ose më shumë konsumatorë të vendosur në të njëjtin bllok ose ndërtesë shumë-banesore mund të bëhen Prosumatorë që veprojnë bashkërisht.
- kanë dhënë një autorizim personit/subjektit përfaqësues për menaxhimin e autorizimit të të gjitha subjekteve që i përkasin Prosumatorëve që veprojnë bashkërisht dhe për të kërkuar dhe marrë përfitimet e ofruara nga skema mbështetëse

SFIDAT/OPSIONET PER TE ARDHMEN

- Virtual Prosumet (Peer-to-Peer Trading)
- Demand Desponse/Flexibility
- Ndarje/Sharing e pikave te konsumit qe posedon nje konsumator
- Subvencione/Lirime nga tatimet dhe taksat



Faleminderit!